



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

2889
Nr. _____ Prot

Peshkopi, më 28.07.2023

Lënda: Dërgim vendimi

Drejtuar: Prefekti i Qarkut Dibër

Bashkëngjitur po ju dërgojmë për konfirmim Vendimin e Këshillit Bashkiak Dibër Nr.77

Datë: 25.07.2023

“Për përmisimin e Shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e 3-të, Bashkia Dibër”

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Sekretari i Këshillit Bashkiak





BASHKISË PESHKOPI
Nr. 2889/1
Këshilli Ditor 02/08/23

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DIBËR

Nr.780/1.prot.

Peshkopi, më 01.08.2023

Lënda : Per vendimin nr. 77, datë 25.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër

BASHKISE DIBER

PESHKOPI


Në mbështetje të ligjit nr.107/2016, date 27.10.2016 "Për Prefektin e Qarkut", neni 16, pasi verifikova për efekt ligjshmërie vendimin e Këshillit të Bashkisë Dibër nr.77, date 25.07.2023 "Për përmisimin e Sherbimeve në Qendrën Ditore për moshën e 3-të, Bashkia Dibër", konstatova se:

Në kuptim të nenit 64, shkronja "gj", përmendet se kryetari i bashkisë "ushtron të drejtat dhe siguron plotesimin e të gjitha detyrimeve që i janë ngarkuar bashkisë si person juridik dhe është përfaqësuesi i saj në marrëdhënie me të të tretët".

Parë problemin në këndvështrim të dispozites së mësipërme, lidhur me aktin administrativ objekt verifikimi dhe shqyrtimi që bën pjesë në fushën e kompetencave të veta të organeve të vetëqeverisjes vendore , kryetari i bashkisë nëpërmjet strukturave të posaçme gëzon të gjithë të drejtat dhe detyrimet lidhur me Marrëveshjen Standarte të Bashkepunimit në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe akteve të tjera ligjore që janë në veprim për të filla raste .

Referuar si më sipër, Prefekti miraton në parim vendimin nr.77, datë 25.07.2023 të Këshillit të Bashkisë Dibër, në kushtet e zbatimit dhe respektimit të legjislacionit aktual që rregullon marrëdhëniet juridike në fushën kontraktore, veprime që kurdoherë janë pergjegjesi direkte administrativo- ligjore e strukturave pergjegjëse që kanë paraqitur për miratim këtë projekt akt.

PREFEKTI
Nexhbedin SHEHU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR
KËSHILLI BASHKIAK DIBËR

VENDIM

Nr. 77 Datë 25 / 07 / 2023

“ Për përmisimin e Shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e 3-të, Bashkia Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; ligjin nr.121 të vitit 2016 “Për shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë” ; si dhe Planin Social të miratuar nga Bashkia Dibër, Këshilli Bashkiak në mbledhjen e datës **25.07.2023**, me 18 vota pro , 0 kundër dhe 0 apstenim:

VENDOSI:

1. Miratimin e Projektit “Përmisimi i Shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e tretë në Dibër”, të financuar nga Programi “Leave no one Behind” Programme (LNB2) UNPD me një vlerë **2.406.215** lekë nga UNDP.
2. Bazuar në Marrëveshjen Standarte të Bashkëpunimit 80% e vlerës të projektit (2.406.215) do të ofrohet nga UNDP dhe 20% e vlerës së projektit (593.500) do të ofrohen nga Bashkia Dibër.
3. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Social, Struktura e Integritimit European dhe Ndihmës së Huaj dhe Drejtoria Ekonomike.
4. Ky vendim hyn në fuqi pas shprehjes për bazueshmëri ligjore nga ana e Institucionit të Prefektit të Qarkut Dibër.
5. Vendimi u shpall me datë **25.07.2023**

Kryetare Këshillit Bashkiak

Irini Shehi



3



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA DIBËR
STRUKTURA E INTEGRIMIT DHE NDIHMËS TË HUAJ



PROJEKT - VENDIM
Nr. 1, Date 27 / 06 / 2023

Për miratimin e Projektit:

“Përmirësimi i Shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e tretë në Dibër”

Në mbështetje të ligjit nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjin Nr. 121 të vitit 2016, “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, si dhe Planin Social të miratuar nga Bashkia Dibër.


Kërkojmë:

1. Miratimin e projektit “Përmirësimi i Shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e tretë në Dibër” të financuar nga Programi “Leave No One Behind” Programme (LNB2), UNPD, me një vlerë 2 406 215 lekë nga UNDP.
2. Bazuar në Marrëveshjen Standarde të Bashkëpunimit 80% e vlerës të projektit (2 406 215 lekë) do të ofrohet nga UNDP dhe 20% e vlerës të projektit (593 500) do të ofrohen nga Bashkia Dibër.
3. Në zbatim të këtij vendimi ngarkohet Sektori i Shërbimit Social, Struktura e Integrimit Evropian dhe Ndihmës të Huaj dhe Drejtoria Ekonomike.


Për Bashkinë Dibër:

Spektori i Shërbimit
Social

z. Ardit HOXHA


Struktura e Integrimit Evropian
dhe Ndihmës të Huaj
z. Ardit VRANIÇI

Drejtoria Ekonomike
z. Mensur SHEHI


Sektori Juridik
z. Elona LUSHA


KRYETARI I BASHKISË
Rahim SPAHIU



**MARRËVESHJE STANDARTE
MES
PROGRAMIT TË KOMBEVE TË BASHKUARA PËR ZHVILLIM DHE
BASHKISË SË DIBRËS**

**MBI ZBATIMIN E PROGRAMIT TË PËRBASHKËT TË KOMBEVE TË BASHKUARA 'ASKUSH TË
MOS MBETET PAS' FAZA 2/LNB2
KU UNDP KA ROLIN E PALËS ZBATUESE**

/E nderuar,

1. Duke iu referuar bisedimeve të zhvilluara ndërmjet punonjësve të Programit për Zhvillim të Kombeve të Bashkuara në Shqipëri (këtu e më poshtë referuar "UNDP") dhe punonjësve të Bashkisë së Dibrës në lidhje me realizimin e aktiviteteve nga Bashkia Dibrë, në zbatim të projektit të Programit të Përbashkët të OKB-së nr. 00126393 "Askush të mos mbetet pas" Faza 2/LNB2, si pjesë e aktivitetit 1.2.3 'siç specifikohet në Shtojcën 1: Dokumenti i Projektit, për të cilin UNDP është zgjedhur si pala zbatuese.
2. Në përputhje me aktivitetet e Programit LNB2, si dhe me termat dhe kushtet e mëposhtme, ne konfirmojmë pranimin e aktiviteteve që do të zbatohen nga Bashkia e Dibrës sipas projektit, siç përcaktohet në Shtojcën 2: Përshkrimi i Aktiviteteve (këtu e më poshtë "Aktivitetet"). Bashkia e Dibrës dhe UNDP do të kryejnë konsulta të vazhdueshme lidhur me të gjitha aspektet e Aktiviteteve.
3. Bashkia e Dibrës do të jetë tërësisht përgjegjëse për të zbatuar të gjitha Aktivitetet me kujdesin dhe efikasitetin e duhur, të të gjitha aktiviteteve në përputhje me rregulloret e saj financiare, rregullat dhe direktivat e tjera, vetëm në masën që ato janë në përputhje me Rregulloret dhe Rregullat Financiare të UNDP-së. Në të gjitha rastet e tjera, rregulloret dhe rregullat financiare të UNDP-së duhet të ndiqen.
4. Për sa i përket zbatimit të aktiviteteve të përcaktuara me hollësi në këtë Marrëveshje, personell dhe nën-kontraktuesit Bashkisë së Dibrës nuk do të konsiderohen në asnjë aspekt si punonjës apo përfaqësues të UNDP-së. UNDP nuk mban përgjegjësi lidhur me pretendime ligjore që lindin nga veprime apo mosveprime nga ana e Bashkisë së Dibrës apo personelit të saj, apo të kontraktuesve të saj apo personelit të këtyre të fundit, gjatë kryerjes së Aktiviteteve sipas projektit; apo ndonjë pretendim ligjor për vdekje, plagosje, paafësi, dëme në pronë apo rreziqe të tjera që mund të pësojë Bashkia e Dibrës apo personeli saj si pasojë e punës që ata kryejnë lidhur me zbatimin e projektit.
5. Të gjithë nënkontraktuesit, përfshirë edhe OJF-të që do të lidhin kontratë me Bashkinë e Dibrës do të punojnë nën mbikëqyren e funksionarit të caktuar nga Bashkia e Dibrës. Këta nënkontraktues do të do të mbajnë përgjegjësi para Bashkisë së Dibrës për mënyrën për mënyrën e kryerjes së funksioneve të caktuara.
6. Pas nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, UNDP do të kryejë pagesat drejt Bashkisë së Dibrës në përputhje me kalendarin e pagesave të përcaktuar në Shtojcën 3: Kalendarin e Aktiviteteve, Mjeteve dhe Pagesave.
7. Bashkia e Dibrës nuk do të marrë asnjë angazhim financiar dhe nuk do të kryejë asnjë shpenzim që e tejkalon buxhetin e caktuar për zbatimin e projektit, siç parashikohet në Shtojcën 3. Bashkia e Dibrës do të konsultohet rregullisht me UNDP lidhur me gjendjen dhe përdorimin e fondeve si dhe do ta informojë menjëherë UNDP në rast se Bashkia e Dibrës është në dijeni që buxheti për zbatimin e këtyre Aktiviteteve është i pamjaftueshëm për zbatimin e plotë të projektit, në përputhje me mënyrën e parashtruar në Shtojcën 2. UNDP nuk do të ketë asnjë detyrim për t'i dhënë fonde Bashkisë së Dibrës apo për t'i kompensuar kësaj të fundit shpenzime që shkojnë përtej totalit të buxhetit të përcaktuar në Shtojcën 3.
8. Bashkia e Dibrës do të dorëzojë raportin e parë narrativ dhe financiar përkatësisht brenda 2 (dy) javëshit të parë të muajit dhjetor 2023 dhe raportin final brenda 2 (dy) javëshit të parë të muajit korrik

DocuSigned by:

Entela Lako

53E89C3E599042D...



2024. Raporti do t'i dorëzohet UNDP-së përmes Përfaqësuesit/es së Përhershëm të UNDP në Shqipëri. Formati do të ndjekë raportin standard të shpenzimeve të UNDP përmes formularit FACE i cili do të sigurohet nga UNDP. Një model i Formës FACE është dhënë në Shtojcën 4.

9. Bashkia e Dibrës do të dorëzojë raporte progresi në lidhje me aktivitetet e zhvilluara, sikundër mund të kërkohej në mënyrë të logjikshme nga menaxheri i projektit, përgjatë kohës së zbatimit të tij.
10. Bashkia e Dibrës do të paraqesë një raport përfundimtar jo më vonë se 1 muaj pas përfundimit apo ndërprerjes të projektit, ku do të përfshihet një listë e pajisjeve të blera nga Bashkia e Dibrës si dhe të gjitha pasqyrat financiare dhe regjistrat e audituara apo çertifikuara që lidhen me aktivitetet e projektit në fjalë, bazuar në rregullat financiare.
11. Pajisjet dhe mjetet që mund të sigurohen nga UNDP ose të prokuruarat përmes fondeve të UNDP-së do të disponohen siç është rënë dakord, me shkrim, ndërmjet UNDP-së dhe Bashkisë së Dibrës.
12. Çdo ndryshim në Dokumentin e Projektit që do të ndikonte në punën e kryer nga Bashkia e Dibrës në përputhje me Shtojcën 2, rekomandohet të bëhet vetëm pas konsultimeve mes palëve.
13. Për të gjitha çështjet që nuk mbulohej në mënyrë specifike nën këtë Marrëveshje, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Dokumentin e Projektit apo në versionet e ndryshuara të tij, si dhe dispozitat përkatëse të Rregulloreve dhe rregullave Financiare të Bashkisë së Dibrës dhe UNDP-së.
14. Rregullimet e parashtruara në këtë Marrëveshje do të mbeten në fuqi deri në përfundim të projektit, ose deri në përfundim të aktiviteteve të Bashkisë së Dibrës sipas përcaktimeve në Shtojcën 2, ose deri sa kjo marrëveshje të anulohet me shkrim (me njoftim paraprak prej të paktën 30 ditë) nga secila prej palëve. Kalendari i pagesave i përcaktuar në Shtojcën 3 do të mbetet në fuqi, në bazë të performancës së realizimit të aktiviteteve në mënyrë të vazhdueshme nga ana e Bashkisë së Dibrës përveç rasteve kur kjo e fundit merr njoftim me shkrim nga UNDP për të kundërtën.
15. Çdo fond i pashpënzuar dhe i paangazhuar pas përfundimit të Aktiviteteve do t'i kthehet UNDP-së brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve.
16. Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshjeje do të kryhet përmes një marrëveshjeje të përbashkët me shkrim.
17. E gjithë korrespondenca e mëtejshme në lidhje me këtë Marrëveshje, përveç marrëveshjeve të nënshkruara ose ndryshimeve të tyre, duhet t'i drejtohet znj. Monica Merino, Përfaqësuese e Përhershme e UNDP, Rruga Skënderbej, ndërtesa Volkswagen, kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri.
18. Bashkia e Dibrës do ta informojë Përfaqësuesen e Përhershme të UNDP-së në Shqipëri në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha veprimet e ndërmarra prej saj në zbatim të kësaj marrëveshjeje.
19. UNDP mund të pezullojë këtë Marrëveshje, tërësisht ose pjesërisht, me njoftim me shkrim, nëse linden rrethana që rrezikojnë përfundimin me sukses të Aktiviteteve të planifikuara.
20. Çdo mosmarrëveshje mes UNDP-së dhe Bashkisë Dibrë që vjen si pasojë apo ka lidhje me këtë Marrëveshje, dhe që nuk zgjidhet përmes negociatave apo rrugëve të tjera të pranuar të zgjidhjes, do t'i paraqitet një Gjykatë të përbërë prej tri arbitrash. Secila palë do të caktojë një arbitër, ndërsa dy arbitrat e caktuar do të caktojnë të tretin, i cili do të jetë edhe kryetar i Gjykatës të Arbitrazhit. Nëse arbitri i tretë nuk caktohet brenda 15 ditëve nga caktimi i dy arbitrave të parë, secila prej palëve mund t'i kërkojë Presidentit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të caktojë këtë arbitër të tretë si më lart. Gjykata e Arbitrazhit do t'i përcaktojë vetë procedurat e saj, me kusht që çdo dy arbitra do të përbëjnë kuorumin për të gjitha qëllimet dhe të gjitha vendimet të kërkojnë miratimin e të paktën dy arbitrave. Shpenzimet e Gjykatës së Arbitrazhit do të përballohen nga palët, sipas vlerësimit të Gjykatës së Arbitrazhit. Vendimi i arbitrazhit do

BASHKIA DIBËR


të përmbajë një deklaratë e cila do të parashtrojë arsyet mbi të cilat ky vendim është bazuar dhe do të jetë i formës së prerë dhe i detyrueshëm për të gjitha palët

21. Nëse bini dakord me dispozitat e parashikuara më lart, ju lutem nënshkruani dy kopje të kësaj Marrëveshjeje dhe dërgojini në këtë zyrë. Pranimi nga ana juaj do të përbëjë bazën për pjesëmarrjen e Bashkisë tuaj në zbatimin e projektit.

Juaja/i sinqerisht,

Nënshkruar në emër të UNDP

Z. George Peradze
Përfaqësues i Përhershëm i UNDP në Shqipëri



Nënshkruar në emër të Bashkisë Diber

Z. Rahim Spahiu
Kryetar i Bashkisë Diber


21 qershor 2023





Shtojca1

DOKUMENTAT E PROJEKTTIT



LNB2 Programme link: <https://www.undp.org/albania/projects/leave-no-one-behind-programme-phase-two-lnb2#:~:text=Summary,and%20social%20inclusion%20in%20Albania>

DocuSigned by:
Entila Lako
53E89C3E599942D...



Shtojca 2

PËRSHKRIMI I AKTIVITETEVE

Projekti i UNDP Nr: 00126393

Titulli i Projektit: Programi i Përbashkët i OKB-së "Askush të mos mbetet pas", Faza 2/LNB2 aktiviteti 1.2.3 'Mbështetje për projektet për shërbime të reja inovative në nivel lokal, në përputhje me rregulloren e skemës së granteve'.

Rezultatet që duhet të arrihen nga Bashkia Diber

Titulli i Projektit: "Përmirësimi i shërbimeve në Qendrën Ditore për moshën e tretë në Diber"

Qëllimi i Projektit: Projekti synon të projektojë hapësira të përshtatshme fizike dhe të ofrojë shërbime sociale për të moshuarit në bashkinë Diber, duke nxitur një atmosferë miqësore për këtë grupmoshë.

Objektivat Kryesore:

- **Objektivi 1:** Përmirësimi i kushteve të hapësirave fizike si dhe i kushteve higjieno-sanitare në ambientet e qendrës të moshës të tretë duke përmirësuar cilësinë e shërbimit për moshat e treta në qendër
- **Objektivi 2:** Krijimi i shërbimeve sociale komunitare dhe gjithëpërfshirëse duke sjellë angazhim aktiv në komunitet të kësaj grupmoshe
- **Objektivi 3:** Ndërmarrja e Inicativave ndërgjegjësuese rreth shëndetit sëbashku me partnerët lokal dhe organizatat duke e informuar këtë grupmoshë rreth kujdesit shëndetësor.

Rezultatet e pritshme:

- **Rezultati 1:**

- Ambienti i qendrës prej 100 m² i restauruar bazuar në standartet e një qendre për moshat e treta
- Tualetit prej 8 m² në ambientet qendrës i restauruar dhe janë vendosur me pajisjet e nevojshme
- Qendra e mobiluar me 4 tavolina, 16 karrige dhe banakun e shërbimit për kafën

- **Rezultati 2:**

- Shtypi periodik mbërrin çdo ditë pranë qendrës dhe me 25 gazeta për të moshuarit
- 70 të moshuarve i'u ofrohet kafeja e mëngjesit nga qendra në bashkëpunim me partnerët

- **Rezultati 3:**

- Krijimi i partneritetit me Drejtorinë e Kujdesit Shëndetësor Parësor për të ofruar shërbime periodike pranë qendrës
- 70 të moshuar të informuar rreth përkuqjesjes shëndetësore

Përfituesit e Projektit:

Përfitues të drejtpërdrejtë:

- 70 të moshuar që frekuentojnë Qendrën ditore të moshës të tretë në Diber
- Familjet e të moshuarve

Përfitues jo të drejtpërdrejtë:

- Komuniteti në Diber
- Institucionet lokale dhe qëndrore
- Organizatat

Puna që do të kryhet nga Bashkia e Dibrës

Përshkrimi i aktiviteteve që do të kryen nga Bashkia e Dibrës:

Objektivi 1. Rehabilitim i ambjenteve fizike dhe i kushteve higjieno-sanitare të qendrës së moshës së tretë duke përmirësuar cilësinë e shërbimit në qendër.

Aktiviteti 1.1 Rikonstruksioni i tualetit të qendrës me një sipërfaqe prej 8m² dhe instalimi i paisjeve hidro-sanitare. Ky aktivitet do të realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve pranë Bashkisë Dibrë, ndërsa ndërhyrja paraqitet tepër e nevojshme si rezultat i kushteve relativisht të vështira që gjendet tualeti aktualisht.

Aktiviteti 1.2 Mobilimi i qendrës me 4 tavolina, 16 karige dhe banakun e shërbimit për kafen. Ky aktivitet do të mundësojë ndërlimin e mobiljeve aktuale të amortizuara dhe të dala jashtë funksionit. Mobilimi do të krijojë kushte më të përshtatshme për ofrimin e shërbimeve dhe ambjent më të përshtatshëm për moshën e tretë.

Aktiviteti 1.3 Lyerja e ambjenteve të qendrës dhe mirëmbajtja e këtij ambjenti nga Drejtoria e Shërbimeve të Bashkisë Dibrë. Lyerja e ambjenteve do të realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë e Shërbimeve të Bashkisë Dibrë. Mirëmbajtja e ambjenteve do të realizohet gjatë 12 muajve të ardhshëm nga drejtoria e Shërbimeve pranë Bashkisë Dibrë.

Objektivi 2. Krijimi i shërbimeve sociale komunitare dhe gjithëpërfshirëse duke sjellë angazhim aktiv në komunitetin të kësaj grupmoshe.

Aktiviteti 2.1 Nënkontraktimi i një kompanie e cila do ta furnizojë me shtypin periodik përgjat një viti qendrën. Ky aktivitet do të mundësojë që çdo ditë pranë qendrës të mbërrijë shtypi periodik.

Aktiviteti 2.2 Ofrimi i shërbimit së kafesë të mëngjesit për moshën e tretë sëbashku me partnerët e Kryqit të Kuq. Ky aktivitet do t'ju mundësojë të moshuarve kafen e mëngjesit falas si një shërbim për kalimin e kohës së lirë me personat e tjerë që i përkasin këtij target grupi dhe që frekuentojnë qendrën.

Objektivi 3. Ndërmarrja e iniciativave ndërgjegjësuese rreth shëndetit sëbashku me partnerët lokal dhe organizatat duke e informuar këtë grupmoshë rreth kujdesit shëndetësor.

Aktiviteti 3.1 Krijimi i grupit i cili do të ofrojë konsulencë pranë qendrës dhe do organizojë aktivitete rreth kujdesit shëndetësor për këtë target grup.

Aktiviteti 3.2 Informim dhe përkujdesje për të moshuarit dhe organizimi i një aktiviteti në ditën ndërkombëtare të të moshuarve.

Përshkrimi i burimeve:

Për të përmbushur qëllimin e projektit dhe objektivat e tij, Bashkia e Dibrës me mbështetjen e UNDP do të përdorë burime të arsyeshme përfshirë burimet njerëzore dhe burimet financiare:

Burimet për gjithë aktivitetet

- Bashkia Dibrë do të angazhojë Drejtorinë e Shërbimeve pranë Bashkisë Dibrë për të kryer punimet rehabilituese për qendrën e të moshuarve.
- Bashkia Dibrë do të kryejë të gjitha proceset prokuruese për të realizuar këtë projekt.
- Bashkia Dibrë do të krijojë partneritete dhe nën-kontaktime në bazë të rregullave dhe procedurave të saj mbi ofrimin e shërbimeve për personat e grupmoshës së tretë.

Aneksë:

Bashkëlidhur, sipas nevojës, një përshkrim pune për konsulentë, terma reference për të kontraktuarit, specifikime teknike për pajisjet, formate të regjistrimit gjatë trajnimeve etj.

DocuSigned by:

Entela Lako

53E88C3E599942D...

Shtojca 3
Kalendari i Aktiviteteve, Mjeteve dhe Paguesave
Viti 2023-2024

PRODUKTIET E PRIITSHME dhe treguesit, përshirë synimet vjelore	AKTIVITETET E PLANIFIKUARA Rendisi të gjitha aktivitetet që duhen ndërmarrë gjatë vitit për arritjen e rezultateve të siprehëna	Kalendari i punës 12 muaj				Peshkrimi i Burimit	Shuma në ALL	Me firmosjen e marrveshjes	Pas dorezimit dhe pranimit të raportit Dhjetor 2023
		Q 1	Q 2	Q 3	Q 4				
Objektiv 1: Rehabilitimi i ambienteve fizike dhe i kushteve higjieno-sanitare të qendrës së moshës së tretë duke përmirësuar cilësinë e shërbimit në qendër Treguesit: 1. Ambjentet e rehabilituara 2. Prokurimi i pajisjeve për qendrën.	Aktiviteti 1.1: Rikonstruksioni i tualetit të qendrës me një sipërfaqe prej 8m ² dhe instalimi i pajisjeve hidro-sanitare		X			Punime Rikonstruksioni			
			X			Pagesë për pajisje	1,526,215	1,526,215	
				X			Pagesë për pajisje		
Objektiv 2: Krijimi i shërbimeve sociale komunitare dhe gjithëpërfshirëse duke sjellë angazhim aktiv në komunitet të kësaj grupmoshe Treguesit: 1. Numri i shërbimeve lehtësuese në qendër 2. Numri i përfituesve të shërbimit	Aktiviteti 1.3: Punime rehabilituese dhe mirëmbajtje Aktiviteti 2.1: Nënkontraktimi i një kompanie për shtypin periodik Aktiviteti 2.2: Ofrimi i shërbimit të kafesë së mëngjesit për moshën e tretë		X	X	X	Pagesë për pajisje			
			X	X	X	Pagesa totale për shtypin periodik	360,000	180,000	180,000
		X	X	X	X	Pagese për shërbimin e kafesë	480,000	240,000	240,000

Objektiv 3: Ndërmarrja e iniciativave ndërgjegjësuese rreth shëndetit sëbashku me partnerët lokal dhe organizatat duke e informuar këtë grupmoshë rreth kujdesit shëndetësor	Aktiviteti 3.1: Krijimi i grupit i cili do të ofrojë konsullencë pranë qendrës		Refreshments	20,000	20,000	420,000
	Aktiviteti 3.2: Informim dhe përkujdesje për të moshuarit					
Treguesit: 1. Numri i konsultave për shëndet publik 2. Numri i përfituesve nga kujdesi shëndetësor						
		X				
		X		20,000	20,000	
			Materiale vizibiliteti			
			Total	2,406,215	1,986,215	420,000

Shënimi:

- Rregullimet brenda secilit prej seksioneve mund të bëhen në konsultime ndërmjet UNDP-së dhe Bashkisë së Dibrës. Këto rregullime mund të bëhen nëse ato janë në përputhje me dispozitat e Programit Mbeshkëtës/Dokumenit të Projektit dhe nëse gjykohet se ato janë në interesin më të mirë të projektit.

VA DIBEL



7 DIBEL

Shtojca 4

Forma e FACE

Funding Authorization and Certificate of Expenditures

County:

Project Code & Title: _____

Fiscal Year: _____

Requesting Agency: _____

Date: _____

Type of Request:
 Direct Cash Transfer (DCT)
 Financial Assistance
 Other Payment

Agency Description (see RFP with Duration)	Coding by UNDP, UNFPA and UNICEF	REPORTING				REQUESTS / AUTHORIZATIONS	
		Approved Amount (\$/USD/€)	Actual Project Expenditure	Expenditures - approved by Agency	Balance	Unspent Period & Amount	Balance Authorized Amount
		a	b	c	d = a - b - c	e	f

CERTIFICATION
 The undersigned, Authorized Officer of the above mentioned implementing institution hereby certifies that:
 The funding request shows that the project is eligible to be funded by UNDP and/or UNICEF and/or UNFPA.
 The amount requested for the period stated herein has been determined in accordance with the RFP and request with approved new estimates. The related accounting documents for these expenditures can be made available by request, when required, for the period of 60 days from the date of the provision of this form.

Date Submitted: _____
 Name: _____ Title: _____

FOR AGENCY USE ONLY

FOR ALL AGENCIES		FOR UNDP USE ONLY		FOR UNICEF USE ONLY	
Signature:		Account Officer	Director/ Manager	Staff/ Finance Manager	
Name:		Cash Transfer Administrator	DCT Administrator	Signature:	
Title:		Country/ Agency/ Department/	Country/ Agency/ Department/	Signature:	
Date:				Signature:	

FACE Form

DocuSigned by:
Entela Laka
 53E89C3E599942D...

(Handwritten mark)

Nr.	Pershkrimi i zerave te buxhetit	Mjesia (p.sh. cope ore/ dite pune, persona ne muaj, muaj, vit, shumaj)	Sasia	Kosto per mjesi ne Lek	Kosto totale ne Lek	Kontributi kenqar nga Fondi Social	Kontributi vet (nese ka)
1.	Burimet njerëzore						
1.1	Pagat dhe kostot perkatëse Menaxheri i Projektit	muaj	12	40,000	480,000	0	480,000
	Nën totali 1				480,000	0	480,000
2.	Pajisjet dhe furnizimet						
2.1	Mirëmbajtje e ambienteve	muaj	12	4,500	54,000	0	54,000
2.2	Shpenzime energjie dhe uji	muaj	12	4,500	54,000	0	54,000
	Nën totali 2				108,000	0	108,000
3.	Shpenzime për aktivitete (sipas planit të punës)						
3.1	Përmirësimi i kushteve të hapsirave fizike si dhe i kushteve higjieno-sanitare në ambientet e qendrës të moshës të tretë duke përmirësuar cilësinë e shërbimit për moshat e treta në qendër	preventivi dhe projekti inxhinjierik	1	1,526,215	1,526,215	1,526,215	0
3.2	Krijimi i shërbimeve sociale komunitare dhe gjithëpërfshirëse duke sjellur angazhim aktiv në komunitetit të kësaj grupmoshe.				840,000	840,000	0
3.2.1	2.1. Nënkontraktimi i një kompanie e cila do ta furnozojë me shtypin perioik përgjat një viti qendren.	muaj	12	30,000	360,000	360,000	0
3.2.2	2.2. Ofrimi i shërbimit të kafesë të mëngjesit për moshat e treta sëbashku me partnerët e Kryqit të Kuq.	muaj	12	40,000	480,000	480,000	0
3.3	Nëdërmarrja e iniciativave ndërgjegjësuese rreth shëndetit sëbashku me partnerët lokal dhe organizatata duke e informuar këtë grupmoshë rreth kujdesit shëndetësor.				25,500	20,000	5,500
3.3.1	3.1. Krijimi i grupit i cili do të ofroj kunsulencë pranë qendrës dhe do organizoj aktivitetet rreth kujdesit shëndetësor për këtë target grup	lump sum	1	5,500	5,500	0	5,500
3.3.2	3.2 Dita ndërkombëtare e të moshuarve	lump sum	1	20,000	20,000	20,000	0
	Nën totali 3				2,391,715	2,386,215	5,500
4.	Vizibilitet, botime, përkthime, etj.	cope	1	10,000	10,000	10,000	0

Ju lutemi ofroni detaje te nevojshme per te treguar si keni arritur ne shumat e deklaruar ne ju lutemi shini rreshtat dhe zero te qe nuk jane te nevojshme dhe me pas llogarisi shumat

VA DIBET

Plakate	code	1	10,000	10,000	10,000	0
Ne totali 4			20,000.0	20,000.0	20,000	0
I SHPENZIME DIREKTE (Nr. 1-4)			2,999,715.00	2,406,215	593,500	
II Shpenzime fikse (indirekte) 3 (maksimumi 10% e totalit te shpenzimeve direkte te Projektit)			0	0	0	0
Ne totali			0	0	0	0
TOTALI (a)			2,999,715.00	2,406,215.00	593,500	

LA DIBËR

Financimi: Leave No One Behind			
Buxheti detajuar: Bashkia: Dibër			
Titulli Projektit: Përmirësimi i Shërbimeve në Qendren Ditore për Moshën e tretë në Dibër			
Kohëzgjatja e Projektit: 12 muaj			
	Të gjitha në Lek		%
Kostot Totale	2,999,715		100
Kontributi i kërkuar nga LNB	2,406,215		80
Kontributi i vet (nëse ka)	593,500		20
Kontributi nga partnerë të tjerë - ju lutemi specifikoni	0		0

VA DIBER



PREVENTIV


Objekti: Rikonstruksion i Qendres se moshes se trete prane Pallatit te Kultures
Peshkopise, Bashkia Diber

Nr.	NR.AN	PERSHKRIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	ÇMIMI	VLERA
3		PUNIME NE/AMBUENTE TE BRENDESHME				
1	2.297/b	Tavan i varur me gipsi	m2	100.0	2,132	213,200
2	2.262/3	Shtrese betoni C 12/15 nivelim dyshemeje	m3	0.5	8,173	4,087
3	2.37/3a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 3.0 km	m3	2.5	255	638
4	2.312	Suva brenda mur guri h~4m me krah, llaç perzier M 25	m2	20.0	737	14,740
5	2.273	Davancale mermeri t=3cm per dritare +dyer	m2	1.5	6678	10,017
6	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat importi 60x60cm ne banjo	m2	35.0	2753	96,355
7	2. a-130	Ndricues tip plafoniere ,me llampe fluoreshente 40w,	cope	13.0	2,217	28,821
8	2.383/1	F V dyer te brendeshme druri importi cilesi e l-re.	m2	2.0	21441	42,882
9	2.404	Boje hidroplastike	m2	320.0	174	55,680
10	An	Punime elektrike priza celsa	cope	12.0	4500	54,000
11	2.495	F.V lavaman porcelani importi me mishelator	cope	1.0	10613	10,613
12	2.501	F.V WC allafrenga importi	cope	1.0	18652	18,652
13	2.508	F.V boiler 100 liter importi	cope	1.0	12219	12,219
14	2.515	F.V pilete dyshemeje Ø 50 mm	cope	1.0	1925	1,925
15	2.515	F.V Pilete grumbulluese shume dalje	cope	1.0	860	860
16	2.516/1	F.V Tuba e rakorderi PVC	kg	15.0	493	7,395
17	2.491/b	F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=25mm, t = 2.0 mm, PN 10	ml	30.0	188	5,640
18	2.395/1	F V dyer d/alumini plastike me dopio xham	m2	9.0	15591	140,319
19	2.375/a	Dritare d/alumini dyfish xham.	m2	4.0	10951	43,804
20	An	Kodicioner 24 btu me garanci deri -20.C	cope	1.0	190000	190,000
21	An	Banak me strukture hekuri dhe veshje me MDF	ml	2.0	60000	120,000
22	An	Raft Mejamin 200x200x35cm	cope	1.0	40000	40,000
23	An	Set tavolinash me 4 karrike	cope	4.0	40000	160,000
		SHUMA TOTALE				1,271,846
		T.V.SH.	20%			254,369
		SHUMA ME TVSH				1,526,215

Shenime: Çmimet e preventivit jane ne baze manualit te cmimeve te vitit 2015.

Preventivues :
Ing. Elvis MANGA

PLANIMETRIA E QENDRES SE MOSHES SE TRETJE PRANE PALLATIT TE KULTURES



MIRATOI:
 KRETARIL PESHKISE
 DIBER
 Z. Ramir SPAHIU

SHKALLA: 1 / 100	FAQJA _____
PESHKOPË, 2023	
HARTOR PROJEKTIN Ark. Ervin Shini Ing. Elvis Manga	
PAKESA E PROJEKTI QENDRA E MOSHES SE TRETJE	
INVESTITORI BASHKIA DIBER	
VENDORI I NGJERTIMIT PALLATI I KULTURES - BASHKIA DIBER	



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIBËR

KARTELË SHOQËRUESE E VISTIMIT

TË PRAKTIKËS SHKRESORE

Praktika shkresore bashkëlidhur i është adresuar Bashkisë Dibër nga DIBËR dhe mban nga dërguesi nr 789/ prot. date 02.08.2023 me trajtë të shkurtuar të përmbajtjes (lënda)

Praktika shkresore u protokollua në librin përkatës të Bashkisë Dibër me nr. hyrës prot 2889/ date 02.08.2023

Praktika u drejtohet për administrim:

- Znj/Z Mikant të Këshillat Peshkopi
- Znj/Z
- Znj/Z
- Znj/Z

me porosinë:

Administruesi peshkopi Gjerd Jeta

Afati i përgatitjes së praktikës shkresore (përgjigjes, ectj) së kërkuar nëpërmjet dokumentit të përshkruar më sipër është

Gjerd Jeta

Shënime nga nëpunësi/nëpunësit që përgatitën praktikën (përgjigjen) shkresore:

Peshkopi, më 02.08.2023 NËPUNËSI QË BËN VISTIMIN E PRAKTIKËS

Gjerd Jeta